



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI

Nr. 114/3 prot.

Tiranë, më 25.01.2018

URDHËR

Nr. 57 datë, 25/01/2018

PËR

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 276, 16.07.2015 “PËR SHPALLJE
MONUMENT KULTURE TË KATEGORISË SË II- TË TË DISA OBJEKTEVE NË
QYTETIN E TIRANËS”**

Në vijim të shkresës nr. 43/2, datë 22.01.2018, paraqitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”, relacionit hartuar nga DRKK Durrës në bashkëpunim me specialistët e IMK për propozim të heqjes nga lista e monumenteve të objekteve me emërtimet dhe kodet përkatësisht: pika 24. Banesë tip vilë 3 kate, Rruga “Çamëria” (II-133); pika 58. Banesë tip vilë 2kate, Rruga “Asim Zeneli” (II-167); pika 65. Banesë tip vilë 2 kate, Rr. “Jul Variboba” (II-174); pika 88. Banesë tip vilë 2 kate, Rruga “Tefta Tashko Koco” (II-197); pika 120. Banesë tip vilë 2 kate, Rruga “Barrikadave” (II-229),

KONSTATOVA:

Se është kompetencë e Ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore ndryshimi i urdhrit nr.276, datë 16.07.2015.

Nisur sa më sipër, në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe pikës 1/c, pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, të pikës 3, të nenit 113, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ :

1. Shfuqizimin e pikave 24, 58, 65, 88, 120, të listës pjesë përbërëse e urdhrit nr. 276, datë 16.07.2015, “Për shpallje Monumente Kulturore të kategorisë së dytë të disa objekteve në qytetin e Tiranës”, përkatësisht me emërtime dhe kode: pika 24. Banesë tip vilë 3 kate, Rruga “Çamëria” (II-133); pika 58. Banesë tip vilë 2kate, Rruga “Asim Zeneli” (II-167); pika 65. Banesë tip vilë 2 kate, Rr. “Jul Variboba” (II-174); pika 88. Banesë tip vilë 2 kate, Rruga “Tefta Tashko Koco” (II-197); pika 120. Banesë tip vilë 2 kate, Rruga “Barrikadave” (II-229), të shpallura me urdhër ministri nr.276, dt.16.07.2015.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kulturën, për komunikimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për regjistrimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Instituti i Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

